

VENDIM
Nr. 238, datë 20.4.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 200, DATË 15.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikave 1, shkronja “a”, dhe 2, të nenit 67, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, e vendimit nr. 200, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 prill 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

Paga bazë për gradë për punonjësit e Policisë së Shtetit

Grada	Paga bazë për gradë
Inspektor	61 500
Inspektor i dytë	64 000
Inspektor i parë	67 000
Nënkomisar	75 000
Komisar	82 500
Kryekomisar	93 000
Drejtues	106 000
Drejtues i parë	110 000
Drejtues i lartë	123 000
Drejtues madhor	133 700